



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

NJOFTIM

PËR POZICION TË LIRË PUNE

SEKRETAR I KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 74/2022, të Kuvendit të Shqipërisë, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e kuvendit nr. 67/2020, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, vendimit nr. 325, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit funksionarëve të kabineteve prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve të administratës publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shpall:

- 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin Sekretar i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;

Afati për dorëzimin e dokumentave: data **18.03.2024**

Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:

1. Ndihmon në përgatitjen e materialeve të Komisionerit.
2. Mban evidencën e porosive që merr prej Komisionerit për punonjësit e administratës dhe ndjek përfundimin e dhënies së përgjigjes.
3. Koordinon takimet e planifikuara të Komisionerit me punonjësit e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose personat jashtë saj.
4. Bashkëpunon me funksionarët e kabinetit dhe luan një rol mbështetës për ta.
5. Kujdeset për agjendën dhe korrespondencën e Komisionerit.

Kërkesa të përgjithshme për kandidatët:

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë:

1. Të kenë arsim të lartë, niveli minimal i diplomës “Bachelor”.
2. Të disponojë dëshmi/certifikatë të një gjuhë të BE, avantazh anglisht.

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e protokollit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dokumentet e dosjes së tij personale:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
2. Një kopje të jetëshkrimit.
3. Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
4. Fotokopje e diplomës me listën të notave, nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
5. Fotokopje e librezës së punës.
6. Vërtetim nga punëdhënësi i fundit që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
7. Fotokopje të kartës së identitetit.
8. Vërtetim i gjendjes shëndetësore.
9. Vërtetim i gjendjes gjyqësore.

Për një sqarim të mëtejshëm, mund të kontaktoni në adresën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr.4, Tiranë, si dhe të konsultoni faqen zyrtare në internet www.kqz.gov.al.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse